





Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	09.07.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/1724/15
PËR/ZA/TO:	z. Xhevdet RAMOSAJ Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Deçanit
CC:	z. Rasim SELMANAJ Kryetar i Komunës së Deçanit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Punimi i Sistemit të Ujësjetllësit në Regjionin e Vokshit - Lloqan"

I nderuari z. Ramosaj ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Punimi i Sistemit të Ujësjetllësit në Regjionin e Vokshit – Lloqan " me numër prokurimi: 613-15-027-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Punimi i Sistemit të Ujësjetllësit në Regjionin e Vokshit – Lloqan " me numër prokurimi: 613-15-027-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsy etimi

Komuna e Deçanit si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës së Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " *Punimi i Sistemit të Ujësjetllës në Regjionin e Vokshit – Lloqan* " me numër prokurimi: 613-15-027-521, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.25.06.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit punë me vlerë mesme.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit ku gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve në dispozicion për këtë tender, ka hasur në disa kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes dokumentet përkatëse të kësaj procedure të prokurimit ka konstatuar shkeljet si në vijim: Në Dosjen e përgatitur për këtë tender dhe njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së tek rubrika **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar** tek kërkesa 1. është kërkuar vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimit ose rehabilitimit të ujësjetllësve në tri vitet e fundit, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se 160.000,00 €. Ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare janë kërkuar kopjet e kontratave jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare, duke bashkëngjitur referenca dhe kontrata duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar. Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me Ligjin për Prokurimin publik. Sipas LPP-së nuk është e lejuar që një kërkesë e tillë që vërteton aftësinë teknike ose profesionale të kërkohej në kuadër të rubrikës Kërkesat mbi Gjendjen ekonomike dhe financiare. Legjislacioni në fuqi e parasheh se Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, **por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë ta kërkojë për të dëshmuar aftësinë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.** Për më tepër kur përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara me kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.50 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk mundet të kërkojë që qarkullimi financiar i Operatorëve ekonomik të dëshmohet me kontrata dhe referenca. Me kontrata dhe referenca mund të dëshmohet natyra e punës, data, vendi apo vlera e punëve, por në asnjë mënyrë nuk lejohet që të vërtetohet qarkullimi financiar.

Në njoftimin e publikuar për kontratë dhe në dokumentet e dosjes së tenderit tek rubrika **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional** tek kërkesa 3 është kërkuar Lista e punëtorëve të përhershëm të kompanisë tuaj. Lista e të punësuarave në kompaninë e juaj e vërtetuar nga ATK.

Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) duhet të jetë min. **25 të punësuar**. Në të njëjtën rubrikë është kërkuar që Bartësi kryesor i projektit të ketë **mbi 60% të vlerës së projektit**. Kërkesa këto për të cilat AKK konsideron se janë diskriminuese dhe kufizojnë konkurrencën e lirë ne mes të Operatorëve ekonomik. Gjatë përcaktimit të kërkesave për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh dhe ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të Operatorëve ekonomik të rinj dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që Operatorët e rinj ekonomik të cilët kanë një shkallë të kënaqshme ekonomike, teknike, të kenë mundësinë të konkurrojnë dhe të jenë pjesë e konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Kërkesa e cila është caktuar nga Autoriteti kontraktues që Bartësi kryesor i projektit të ketë **mbi 60% të vlerës së projektit** është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 71 të LPP-së.

Paragrafi 4 i nenit 71 të këtij ligji përcakton si në vijim, "*Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit*".

Paragrafi 4 i nenit 68 të këtij ligji, si dhe paragrafi 8 i nenit 69 të këtij ligji lejon që një operator ekonomik të mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera dhe në këto raste tenderojnë si grup.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin **69** Aftësia Teknike dhe Profesionale dhe nenin **71** Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin **5** Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !